



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**  
**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 297 prot.

Tiranë, më 31.07.2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1128/5, DATË 19.01.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË PARAQITURA NGA SHTETASJA ZNJ. FATIME HEKA”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga znj. Fatime Heka me nr.1434 prot., datë 02.07.2020 dhe nr.1434/2 prot., datë 24.07.2020, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit A.K. me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë në kohën e kryerjes së shkëljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 1128/5 prot., datë 19.01.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të paraqitura nga shtetasja znj. Fatime Heka”, bazuar në nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga: “Jordan Misja”, nr. 135, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

